



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2021:154160  
Datë: 07.07.2022  
Numri i dokumentit: 03250542

**C.nr.672/2021**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të paditësve M. E., E. D. - H., H. C. dhe L. Sh., të gjithë të punësuar në Shkollën “Isa Boletini”, në Rahovec të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati D. M. nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Av. B. O., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit **8,239.44€**, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, më **23.06.2022**, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** padia dhe kërkesëpafia e paditësve M. E., E. D. - H., H. C. dhe L. Sh., si dhe

**DETYROHET** e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t’u paguaj kompensim në emër të diferencës në pagë, për secilin paditës, si vijon:

- Paditëses M. E. për periudhën kohore, 18.04.2017 deri 31.12.2020, t’ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 2,405.92 € ( *shpjegim:* paga bazë 421.00€ x 27% i pagës bazë ( 113.00€ - 58.32 diferencë e paguar në pagë = 54.68€ ) x 44 muaj gjithsej 44x 54.68 = 2,405.92€),
- Paditëses E. D. - H., për periudhën kohore, 18.04.2017 deri 31.12.2020, t’ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 2,405.92 € ( *shpjegim:* paga bazë 421.00€ x 27% i pagës bazë ( 113.00€ - 58.32 diferencë e paguar në pagë = 54.68€ ) x 44 muaj gjithsej 44x 54.68 = 2,405.92€),
- Paditësit H. C. për periudhën kohore, 18.04.2017 deri 31.12.2020, t’ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 1,713.8 € ( *shpjegim:* paga bazë 421.00€ x 19% i pagës bazë ( 79.99€ - 41.04 diferencë e paguar në pagë = 38.94€ ) x 44 muaj gjithsej 44x 38.94 = 1,713.8€),
- Paditëses L. Sh., për periudhën kohore, 18.04.2017 deri 31.12.2020, t’ia paguaj në emër të kompensimit të pagës mbi pagën bazë shumë e përgjithshme prej 1,713.8 € (

shpjegim: paga bazë 421.00€ x 19% i pagës bazë ( 79.99€ - 41.04..32 diferencë e paguar në pagë = 38.94€ ) x 44 muaj gjithsej 44x 38.94 = 1,713.8€), e në shumën e përgjithshme për të gjithë paditësit prej 8,239.44€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë nga data (08.06.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, **SI ME BAZË**.

**DETYROHET** e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej **1,737.00 €** me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Paditësit M. E., E. D. - H., H. C. dhe L. Sh., nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar kësaj gjykate i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të diferencës në pagë.

Sipas kësaj çështje juridike është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor, në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i paditësve avokati D. M., si dhe përfaqësuesi i të paditurës av. B. O..

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve avokati D. M. ka deklaruar: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, pranë propozimit që në shqyrtimit gjyqësor të shqyrtohen provat materiale me të cilat do të vërtetohet se baza juridike e padisë është e pa kontestueshme për faktin se kontrata kolektive e Arsimit të Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, referuar kërkesëpadisë paditësit nga e paditura kërkojnë kompensimin e diferencës në page për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 31.12.2020, në lidhje me legjitimitetin e palëve paditëse vërtetohet përmes Kontratave të punës, vërtetimeve të lëshuara nga Shkolla "Isa Boletini", në Rahovec, për të gjithë paditësit sipas vërtetimeve që gjenden në shkresat e lëndës, sa i përket legjitimitetit të paditësve në kërkesa vërtetohet përmes kontratave të punës të lidhura në mes paditësve dhe të paditurës lartësia e kërkesëpadisë vërtetohet bazuar në listën e pagave referuar pagës baze prej 421 dhe 405 euro dhe diferencës se paguara në raport me përqindjen të cilën e përcakton Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës në nenin 7, andaj konsideron se u vërtetua në tërësi baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, e mbi këtë i propozoi gjykatës që padinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar, shpenzimet të procedurës i kërkuar dhe atë: për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21,00 Euro, për përpilimin e padisë në shumë prej 520,00 Euro, për përfaqësim në seancë shumën prej 676.00 Euro, për precizimin-zgjerimin e padisë në shumë prej 520.00,00 Euro, apo në shumë të përgjithshme prej 1.737.00 Euro, kjo pasi që kemi të bëjmë me përfaqësimin e katër apo me shumë paditësve në këtë çështje kontestimore.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës B. O. ka deklaruar se në tërësi e kontestojnë kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të pathemeltë ndaj të paditurës komuna e Rahovecit me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv duke marrë për bazë se kontrata kolektive është nënshkruar nga organi i nivelit qendror nga MASHT dhe SBASHK ndërsa e paditura nuk ka qenë nënshkruese e kësaj kontrate si nivel lokal kjo në kuptim të nenit 90 paragrafi 2 i Ligjit të Punës me të cilin është paraparë që kontrata kolektive mund të lidhet në tri nivele. E paditura mendon që paditësit duke marrë për atë theksimet si më lart është dashur që kërkesëpadinë ta drejtoj edhe ndaj Ministrisë së Arsimit si nënshkruese të kontratës në fjalë. E paditura në parim nuk ka kundërshtuar dispozitat e Kontratës Kolektive të cilat kanë qëllim përmirësimin e kushteve për mësimdhënësit por që në bazë të dispozitave që kanë implikime financiare nuk ka mundësi buxhetore dhe për të zbatuar këto dispozita pasi që palët kontraktuese

në këtë kontratë nuk kanë zbatuar nenin 46 të së njëjtës. Mbrojtja e të paditurës mbetet në qëndrimin si në përgjigje në padi, ngase kontrata kolektive është nënshkruar në mes të MASHT dhe SBASHK dhe ashtu siç konstaton edhe Gjykata Kushtetuese në rastin numër KO139/18 se kjo kontratë reflekton vullnetin reciprok në mes të dy palëve nënshkruese. Në bazë të dispozitave të Ligjit të Punës respektivisht me asnjë dispozitë të këtij ligji nuk është paraparë e drejta e punëtorit të pensionuar apo në marrëdhënie pune në realizimin e të drejtës për pagesën e pagës përcjellëse, shpërblimit jubilar apo shpenzimeve të rrugës, të ushqimit si në kërkesëpadinë e paditësve, konsiderojnë se paditësit nuk kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë administrative për të realizuar interesin e tyre juridik në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të ligjit numër 06/L-114 për zyrtarët publik. Sa i përket buxhetimit të mjeteve lidhur me kërkesëpadinë e paditësve e paditura në përgjigje në padi ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e alokimit të buxhetit për nivelin lokal siç është e paditura këtu, theksojmë se në bazë të qarkoreve buxhetore të Ministrisë së Financave për vitin 2019, 2020 dhe 2021 në asnjë nga këto qarkore të cilat konsiderohen dokumente bazë për krijimin e buxhetit vjetor, nuk është paraparë respektivisht nuk është alokuar asnjë mjet financiar për kompensimin e ushqimit apo të udhëtimit. Për vitin 2019 komunës së Rahovecit i janë alokuar mjetet në shumën prej 22.967,00 €uro në emër të tri pagave përcjellëse, kjo në bazë të kalkulatorit sipas pikës 2.2 të kësaj qarkore. Në vitin 2020 komunës së Rahovecit i janë alokuar 46.643,00 €uro në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit, ndërsa për vitin 2021 në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit janë ndarë gjithsej 42.150,00 €uro dhe për herë të parë janë ndarë 27.169,00 €uro në emër të pagave jubilarë sipas kontratës kolektive andaj përtej kësaj që është paraparë në Ligjin për Buxhetin e RKS-së dhe ndarjes buxhetore, e paditura nuk ka kompetencë ligjore për të kryer pagesat tjera në emër të kompensimeve sipas kontratës kolektive të arsimit para universitar. Rrjedhimisht për të gjitha vitet sipas kërkesës për kompensimin e ushqimit dhe udhëtimit janë përtej mundësive ligjore për të kryer pagesa sipas kërkesëpadiisë së paditësve. Në aspekt procedural gjykata nuk ka vepruar në përputhje me nenin 67 dhe 68 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i propozojmë gjykatës që kësaj lënde të ia bashkojë edhe lëndë të tjera me paditës me bazë të njëjtë të padisë në emër të parimit të ekonomizimit të procedurës. E paditura, përveç kësaj thekson se kërkesëpadiia në aspekt kohor nuk ka bazë ligjore për arsye se KKAK, ka qenë në fuqi nga data 18.04.2017 deri më 18.04.2020, kjo në kuptim të nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të Punës me të cilin është përcaktuar se kontrata kolektive mund të lidhjet në një afat të caktuar kohor por jo më shumë se tri vite. Po ashtu ka deklaruar se nuk e kundërshtojmë zgjerimin e padisë edhe për paditësit e tjerë dhe nuk e kundërshtojmë tërheqjen e padisë për paditësit si në padi për vitin 2021.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar provat duke bërë shikimin e tyre, ka bërë shikimin e kërkesës drejtuar DKA-së, ka bërë shikimin në listën e pagave për të gjithë paditësit, ka bërë shikimin në kontratat e punës dhe Vërtetimet për paditësin; M. E., Vërtetimi mbi muajt e punës me nr. 195/21. e dt. 02.07.202; Kontrata e punës me nr. të protokolit: 65/18 i dt. 01.04.2018; Diploma e fakultetit; Licenca e mësimdhënësit nr. 100009723 si dhe lista e pagës 31.12.2020; E. D. – H. Vërtetimi mbi muajt e punës me nr. 194/21. e dt. 02.07.202; Kontrata e punës me nr. të protokolit: 66/20 i dt. 01.09.2020; Diploma e fakultetit; Licenca e mësimdhënësit nr. 1027133, si dhe lista e pagës 31.12.2020; H. C., Vërtetimi mbi muajt e punës me nr. 238 /21. e dt. 02.07.202; Kontrata e punës me nr. të protokolit: 77/15 i dt. 01.09.2015; Diploma e fakultetit; Licenca e mësimdhënësit nr. 100009602 si dhe lista e pagës 31.12.2020; L. Sh., Vërtetimi mbi muajt e punës me nr. 241/21. e dt. 02.07.202; Kontrata e punës me nr. të protokolit: 355/19 i dt. 18.11.2019; Diploma e fakultetit; Licenca e mësimdhënësit nr. 100009595 si dhe lista e pagës 31.05.2017.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës për mësimdhënësin M. E. me numër dhe date te lartcekur, dhe se gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës në SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, për periudhën kohore të kërkuar sipas kërkesëpadisë.

Me shikimin në vërtetimin nr. 195/21 vërtetohet se për periudhën 18.04.2017 e deri me datë 31.12.2020 paditësi ka gjithsejtë 44 muaj pune.

Me shikimin në diplomën e shkollimit vërtetohet se paditësi është i kualifikuar me Fakultet ndërsa me shiqimin e Licencës nr. 100009723 u vërtetua se paditësi është i licencuar nga MASHT-i.

Me shikimin në listën e pagave të datës 31.12.2020 u vërtetua lartësia e pagës mesatare në shumën prej 421.00 euro.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës për mësimdhënësin E. De.-H. me numër dhe date te lartcekur, dhe se gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës në SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, për periudhën kohore të kërkuar sipas kërkesëpadisë.

Me shikimin në vërtetimin nr. 194/21 vërtetohet se për periudhën 18.04.2017 e deri me datë 31.12.2020 paditësi ka gjithsejtë 44 muaj pune.

Me shikimin në diplomën e shkollimit vërtetohet se paditësi është i kualifikuar me Fakultet ndërsa me shiqimin e Licencës nr. 1027133 u vërtetua se paditësi është i licencuar nga MASHT-i.

Me shikimin në listën e pagave të datës 31.12.2020 u vërtetua lartësia e pagës mesatare në shumën prej 421.00 euro.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës për mësimdhënësin H. C. me numër dhe date te lartcekur, dhe se gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës në SHFMU “Isa Boletini” në Rahovec, për periudhën kohore të kërkuar sipas kërkesëpadisë.

Me shikimin në vërtetimin nr. 238/21 vërtetohet se për periudhën 18.04.2017 e deri me datë 31.12.2020 paditësi ka gjithsejtë 44 muaj pune.

Me shikimin në diplomën e shkollimit vërtetohet se paditësi është i kualifikuar me Fakultet ndërsa me shiqimin e Licencës me nr.100009602 u vërtetua se paditësi është i licencuar nga MASHT-i.

Me shikimin në listën e pagave të datës 31.12.2020 u vërtetua lartësia e pagës mesatare në shumën prej 421.00 euro.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës për mësimdhënësin L. Sh. me numër dhe date të lartcekur, dhe se gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës në SHFMU "Isa Boletini" në Rahovec, për periudhën kohore të kërkuar sipas kërkesëpadisë.

Me shikimin në vërtetimin nr. 241/21 vërtetohet se për periudhën 18.04.2017 e deri me datë 31.12.2020 paditësi ka gjithsejtë 44 muaj pune.

Me shikimin në diplomën e shkollimit vërtetohet se paditësi është i kualifikuar me Fakultet ndërsa me shiqimin e Licencës nr. 100009595 u vërtetua se paditësi është i licencuar nga MASHT-i.

Me shikimin në listën e pagave të datës 31.12.2020 u vërtetua lartësia e pagës mesatare në shumën prej 421.00 euro.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika 3 dhe pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017, është paraparë se: ***"Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shpërblyer nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: pika 1.3 e nenit 7: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvjeçar, 27 % e pagës bazë, pika 1.2 e nenit 7: Mësimdhënës me Shkollë të lartë Pedagogjike dy vjeqare 19% e pagës bazë"***.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditësve në kuptim të dispozitave të lartcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësve t'ia paguajë pagat në emër të udhëtimit dhe ushqimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vërtetuar në këtë mënyrë gjendjes faktike me prova materiale bindëse, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 7 Pika 1.2 dhe pika 1.3 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, kjo gjykatë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që e paditura t'ia kompensoj paditësve shumën prej 1,737.00 €, e që kanë të bëjnë: për përpilimin e padisë shumën prej 520,00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 21,00 €, për përpilimin e zgjerimit-precizimit të padisë shumën prej 520.00 €, si dhe për përfaqësim në një seancë shumën prej 676.00 €.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**  
**C.nr.672/2021, më 23.06.2022**

**B. Profesional**  
**Armond Qmega**

**Gjyqtari**  
**Betim Behluli**

Numri i lëndës: 2021:154160  
Datë: 07.07.2022  
Numri i dokumentit: 03250542

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.